



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 257 Prot.

Tiranë, më datë 25.04.2025

**VENDIM**

**Nr. 231, datë 25.04.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.04.2025:

**VENDOSI**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për “*Plani i Menaxhimit dhe konservimit arkeologjik, studimit hidrologjik dhe ekologjik për nënzonat e trashëgimisë dhe peisazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit*”, me kërkesë të **Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, me argumentin;**
  - Dokumenti i ‘Planit të Menaxhimit dhe konservimit arkeologjik’ duhet të plotësohet me materialin përkatës grafik për të gjithë monumentet, sipas dokumentit të Termave të Referencës të miratuara me Vendim nr. 565 datë 17.11.2023 të KKTKM.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Joli MITROJORGJI



SEKRETAR  
Bledi GONXHJA